



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Të premten e kaluar, më 6 dhjetor, u bë publike Aktakuza kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit, për akuza që lidhen me pretendime për përpjekje të paligjshme për të ndikuar ndaj dëshmitarëve të dëshmitarëve. Aktakuza mund të gjendet në faqen e internetit të DHSK-së. Gjykatësja e Procedurës Paraprake e konfirmoi Aktakuzën më 29 nëntor.

Në bazë të Aktakuzës të Konfirmuar dhe fletarrestimeve të lëshuara nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake për secilin, z. Smakaj, z. Fazliu dhe z. Kilaj u arrestuan më 5 dhjetor në Kosovë dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 6 dhjetor. Zyra e Prokurorit të Specializuar i kreu arrestimet me mbështetjen e Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

Zotit Thaçi iu dorëzua fletarrestimi i lëshuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, në bazë të Aktakuzës së Konfirmuar, më 5 dhjetor.

Hajredin Kuçit iu dorëzua Aktakuza e Konfirmuar dhe u thirr që të paraqitej para Gjykatës së Procedurës Paraprake për paraqitjen e parë.

Sipas Aktakuzës së Konfirmuar, midis së paku 12 prillit 2023 dhe 2 nëntorit 2023, gjatë vizitave të veçanta të paprivileguara në objektin e paraburgimit, z. Thaçi u dha z. Smakaj, z. Kilaj, z. Fazliu dhe z. Kuçi informacion konfidencial për dëshmitarë të ZPS-së, udhëzoi të akuzuarit që të ndikonin në dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së dhe u dha hollësi se si të vepronin.

Më tej, Aktakuza përmban pretendime se z. Thaçi bashkërendoi tre grupe të veçanta, të përbërë nga z. Smakaj, z. Fazliu dhe z. Kilaj, dhe persona të tjerë për të cilët nuk janë ngritur akuza, si dhe bashkërendoi me z. Kuçi për të ndërhyrë në dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së në proceset penale që po zhvillohen aktualisht.

Kundër z. Thaçi janë ngritur tri akuza për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi; katër akuza për shkelje të fshehtësisë së procedurës; dhe katër pika për mosbindje gjatë gjykatës. Z. Fazliu, z. Smakaj dhe z. Kilaj akuzohen secili me nga një akuzë për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi dhe një akuzë për mosbindje gjatë gjykatës. Kundër z. Kuçi janë ngritur dy akuza për mosbindje ndaj gjykatës.

Në përputhje me Rregulloren e Procedurës dhe Provave të DHSK-së, paraqitjet e para për të pesë të akuzuarit u mbajtën më vete për secilin, më 8 dhe 9 dhjetor 2024.





Fadil Fazliu, Isni Kilaj dhe Hajredin Kuçi u vetëdeklaruan të pafajshëm për të gjitha pikat e Aktakuzës gjatë paraqitjes së tyre të parë. Hashim Thaçi dhe Bashkim Smakaj ende nuk janë vetëdeklaruar lidhur me pikat e aktakuzës. Sipas Rregullores, i akuzuari mund të vetëdeklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë për secilën nga pikat në aktakuzë gjatë paraqitjes së parë ose brenda 30 ditësh pas saj.

Sipas Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban një konferencë mbi ecurinë e çështjes sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit, ndër të tjera, për: organizimin e shkëmbimeve midis palëve për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykim; ndërmarrjen e hapave përkatës për të siguruar që palët t'i kryejnë të gjitha përgatitjet e nevojshme në kohë dhe në mënyrë të zellshme.

Në përputhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, të martën, caktoi konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes për të martën e ardhshme, 17 dhjetor, në orën 14:00.

Në urdhrin e saj, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se konferenca mbi ecurinë e çështjes do të përfshijë diskutime lidhur me nxjerrjen e materialeve, sistemin e redaktimit që do të zbatohet në këtë çështje gjyqësore, si dhe tema të tjera që palët i gjykojnë të nevojshme. Gjithashtu, ajo ftoi Hashim Thaçin dhe Bashkim Smakajn të vetëdeklarohen gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes, nëse dëshirojnë.

Në çështjen gjyqësore kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit lidhur me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, më 11 dhjetor Trupi Gjyqësor miratoi, pjesërisht, kërkesën e Prokurorisë për t'i pranuar dëshmitë e nëntë dëshmitarëve me shkrim. Më 9 dhjetor, Trupi Gjyqësor po ashtu miratoi kërkesën e një dëshmitari për të dhënë dëshmi me masa mbrojtëse përmes videolidhjes.

Në çështjen *Salih Mustafa*, Kryetarja e DHSK-së caktoi një panel të Gjykatës Supreme, më 10 dhe 11 dhjetor, për të vendosur lidhur me dy kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë: përkatësisht një nga z. Mustafa dhe një nga Prokuroria. Të dyja kërkesat lidhen me vendimin e Gjykatës së Apelit me titull Vendim për Lëshimin e një Vendimi të Ri Dënimi për Salih Mustafën.

Z. Mustafa pretendon se paneli i Gjykatës së Apelit ka shkelur ligjin në përcaktimin e dënimit për akuzën e vrasjes së paligjshme dhe i kërkon Panelit të Gjykatës Supreme të caktojë dënim më të ulët për këtë akuzë, ose t'ia kthejë panelit kompetent për vendim të ri. Prokuroria kundërshton ligjshmërinë e dënimit me 15 vjet të dhënë nga Dhoma e Apelit si tepër të ulët dhe i kërkon Panelit të Gjykatës Supreme t'ia kthejë çështjen Panelit të Apelit për të caktuar një dënim të ri.

